



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.274/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqi anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 03.02.2025, merr këtë:

VE N D I M

Refuzohen si të pa bazuara ankesat e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, Anr.274/2025, dhe Anr.275/2025, të datës 31.01.2025, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, gjatë fushatës zgjedhore, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës që do të mbahen më datë 09.02.2025.

A r s y e t i m

Me datën 31.01.2025 PZAP ka pranuar ankesat e identifikuara me numër Anr.274/2025 dhe Anr.275/2025, nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV).

-Në ankesën Anr.274/2025, pretendohet se me datë 30 janar 2025, në ora 17:31/h, mbështetësja e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, aktualisht Koordinatore e Komiteteve në Lëvizjen Vetëvendosje, znj. Dejana Mihali, ka publikuar një postim në rrjetin social Facebook, në të cilën shkruan: *"Bedri Hamza dhe PDK ende nuk u distancuan nga Sami Lushtaku dhe nuk dënuan huliganizmin e shfaqur nga ta në Skenderaj"*, gjuhë e cila përmban nxitje, urrejtje, ofendim, denigrim dhe njëherit shprehë ngjyrimë përçmuese ose nënvlerësuese për Partinë Demokratike të Kosovës, duke aluduar se PDK kanë shfaqur huliganizëm në Skenderaj, respektivisht duke aluduar se të njëjtit janë organizator të incidentit të shkakuar në Komunën Skenderaj. Për qëllime të argumentimit të afatshmerisë së ankesës, PDK njofton PZAP se shpërndarja e postimit në rrjetin social Facebook nga znj. Dejana Mihali është bërë më 30 janar 2025, në ora 17:31/h dhe se postimi vazhdon të jetë

ende aktiv në profilin e të njëjtës. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur: Postimi i publikuar në profilin e znj. Dejana Mihali në rrjetin social Facebook;

<https://www.facebook.com/dejana.mihali/posts/pfbid02uaebzIuvK84g4VxĚ661uXsNdAYMoNpkxb7cie4vaKiIfrKbAsrPsiKDVu4vĚLĚSDI>, si dhe Screenshoot nga postimi i znj. Dejana Mihali, në të cilën dëshmohet data dhe koha e publikimit të postimit me tekst shoqërues.

-Në ankesën Anr.275/2025, pretendohet se më datë 30 janar 2025, në ora 21:27/h, kandidati për deputet nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, z. Haxhi Avdyli, ka publikuar një status në rrjetin social Facebook, e cila vazhdon të jetë e pranishme në profilin e tij, në të cilën deklaron se "5500€ dënim nga PZAP, për fjalinë time " ska kthim prapa për ata për ata që degraduan, e që nuk japin shpresë këtij vendit ". Merrne me mend kjo quhet nxitje e urrejtjes!?!? Nga sot unë tërhiqem nga kritika për ish- qeveritë, Po filloj me "lëvdata", pastaj i njëjti vazhdon këtë status me përdorim të gjuhës nxitëse, përçarëse dhe urrejtëse kundrejt partive kundërshtare, në mënyrë ironike, respektivisht deklaron "Dua të "falenderoj" qeveritë e kaluara që lejuan strukturat paralele të egzistojnë në çdo qytet veri e Jug."Faleminderit" qeverive të kaluara që lejuan bandat kriminale në veri të sundojnë, të pasurohen nga kontrabanda, të rrahin qytetarë, të kallin makina e shtëpi, e që i larguan barrikatadat vetëm pasi erdh kjo qeveri. Krejt me ia fal ama nuk ia "falim" kësaj qeverie kurrë që na ndali dinarin", "Nuk ua "harrojmë" kurrë qeverive të kaluara që lejonin Vuçiqin, e shokët e tij të endeshin nëpër Kosovë e të fyenin shtetin tonë.", "Qeveritë e kaluara "ishin" shpresa vendit. Sepse ata i rritën pagat për KM e ministra, i falen miliona borgje kompanive, e paguan qindra milion dënime e shpenzuan për mirëqenjen e qeveritarëve të vuajtur në paga e luks", duke vazhduar me deklaram ironik, i njëjti deklaron "Shpresoj që PZAP sdo më dënoi edhe për lëvdatat që ia bëra qeverive të kaluara. Sepse PZAP është organi më i pavarur, më i paanshmi, në Kosovë dhe në tërë rruzullin botëror, siq është edhe drejtësia e pavarur në Kosove. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur postimin e kandidatit z. Haxhi Avdyli, i publikuar në rrjetin social Facebook më datë 30 janar 2025, në ora 20:47/h <https://www.facebook.com/haxhi.avdyli.5/posts/pfbid0m9iY58ĚBGHlg2dIZKqĚzJDeĚPE5Gj3xĚxJE3VvvDojbUyxGFĚZqtGĚ79pGĚKuuMlĚ>;

Në përgjigjen për ankesën Anr.274/2025 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, të njëjtën e ka vlerësuar si të pabazuar me pretendimin se deklarata e znj. Mihali në llogarinë e saj në Facebook për të cilën parashtruesi pretendon se janë shkelur dispozita të caktuara zgjedhore, konsiderojmë se është në përputhje me rregullativen dhe frymën e një fushate zgjedhore, se në deklaratën e saj, duke mos përdorur gjuhë e cila do të binte ndesh me rregullat zgjedhore, znj. Mihali ka treguar një fakt të qëndrueshëm dhe disa veprime të anëtarëve dhe mbështetësve, aktivistëve të subjektit përkatës, të cilat përveçse kanë penguar frymën e një gare të mirëqenë elektorale, veprimet e po këtyre, edhe kishin çuar në pengimin e mbajtjes së tubimit elektorale të 27 janarit 2025 në Skenderaj dhe shtyrjes së tij për më shumë se 30 minuta. Për më shumë, znj. Mihali vetëm kërkon që ky subjekt të distancohet dhe të vetë deklarohet se nuk kanë të bëjnë me ngjarjen, e të cilat, konsiderojmë janë legjitime dhe e drejtë e saj që t'i kërkoj nga një subjekt i certifikuar nga KQZ dhe që

përfaqëson një pjesë të popullatës në Kuvendin e Kosovës, që të distancohet nga veprimet e tilla huligane ashtu siç ajo i ka quajtur dhe ashtu siç realisht ato veprime qëndrojnë.

Në përgjigjen për ankesën Anr.275/2025 të subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje LVV, të njëjtën e ka vlerësuar si të pabazuar me pretendimin se kandidati nga radhët e Lëvizjes VETËVENDOSJE! Haxhi Avdyli ka publikuar një status në rrjetin social facebook, ku përmbajtja e këtij statusi nuk mund të kategorizohet në nenin 34 par. 1 nën paragrafi 1.11 të LZP-së, për faktin se përmbajtja e këtij statusi nuk reflekton gjuhë të urrejtjes apo provokim që një person tjetër të kryej një akt të dhunës kundër personave të tjerë. Për më tepër një gjuhë e tillë është përdorur në formë falënderimi për punën e qeverive të kaluara lidhur me qeverisjen e tyre në përgjithësi. Pra falënderimi për punën e bërë nga qeveritë kaluara lidhur me udhëheqjen e shtetit dhe qeverisjen me shtetin, nuk mund të nxisë apo të provokojë ndonjë person tjetër që të kryej ndonjë akt të dhunës ndaj personave të tjerë. Prandaj gjuha e tillë në formë falënderues nuk mund të kategorizohet assesi brenda nenit 34 par. 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosijes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si në vijim: Anr.274/2025, dhe Anr.275/2025, të datës 31.01.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjën e përbashkët A.nr.274/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik PDK kundër subjektit të njëjtë politik LVV, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj dhe vlerësoi ankesat gjeti se:

Ankesat janë të pabazuara

Paneli, pas shikimit të shkresave të lëndës të ofruara si provë materiale, dhe vlerësimit të përgjigjes në ankese ka gjetur se shprehjet e përdorura nga kandidatët dhe mbështetës të subjektit politik LVV, të publikuar në status në rrjetin social Facebook, nga znj.Dejona Mihali dhe z. Haxhi Avdyli, si në ankesat e paraqitura, vlerëson se nuk kemi të bëjmë me gjuhë denigruese dhe urrejtëse në raport me subjektet politike që marrin pjesë në garën zgjedhore. Diskursi i tillë i përdorur nga mbështetësja dhe kandidati i këtij subjekti politik LVV, nuk mund të konsiderohet se mund të nxit ose provokon, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, po ashtu nuk është në kundërshtim me nenin 34 pika 1.11), e LZP-së, në të cilin në nen në mënyrë decisive thuhet se: *“Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëris si në vijim: 1.11) përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë”*.


Sipas panelit, konstatimi për distancim nga një ngjarje nuk konsiderohet si gjuhë denigruese dhe nxitëse të urrejtjes, kjo pasi që i referohet një ngjarje që ka ndodh dhe se për këtë rast subjekti politik PDK është dënuar nga PZAP.

Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: “vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse”, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj se këto veprime paraqesin shkelje të dispozitave të lartcekura ligjore, dhe si të tilla të njëjtat i refuzoi si të pabazuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Anr.274/2025 më datën 03.02.2025

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.